REPUBLIKA E KOSOVËS **KOMUNA E LIPJANIT**
REPUBLIKA KOSOVA **OPŠTINA LIPLJAN**
REPUBLIC OF KOSOVO **MUNICIPALITY OF LIPJAN**

Datë:	12.01.2022
Referencë:	
Për:	**z.Imri Ahmeti** – Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje:	**z.Fauz Xhemajli** – Nënkryetar i Komunës **z.Lulzim Qerimi** – Nënkryetar i Komunës
Nga:	**Anila Reçica Llugiqi** - Drejtoreshë e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport
Lënda:	**RAPORT Mujor - DHJETOR - 2021**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajit dhjetor, në drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale, konform gjendjes së krijuar me pandeminë globale Covid – 19.

Gjatë gjithë muajit është punuar me staf të plotë dhe orar të rregullt, por duke respektuar gjithmonë udhëzimet e IKSHPK-së.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- Kemi bërë raportin për muajin nëntor 2021,
- Kemi bërë kerkesa për shpenzim të buxhetit varësisht nga kerkesat dhe nevojat e departamentit,
- Jemi kujdesur në shpenzimin e buxhetit në kategori të cilat kan afat të caktuar të shpenzimit dhe zotimit,
- Kemi organizuar dekorin e qytetit për festat e fundvitit,
- Jemi kujdesur që të servisohet ngrohja qendrore e objektit të bibliotekës,
- Kemi nderuar të rënërt e fshatit Krojmir me kurora lulesh,
- Kemi pritur në takim ambasadoren Holandeze, për të shpalosur investimet e Uniceff-it që po implementohen nga të rinjët e komunës sonë,
- Kemi pranuar 116 tituj të rinjë dhe 753 ekzemplar, donacion nga MKRS-ja, për të pasuruar fondin librar të bibliotekës së qytetit,
- Kemi marr pjesë në takimin publik me qytetarë të komunës së Lipjanit, të organizuar nga kryetari i komunës z. Imri Ahmeti,
- Në objektin e bibliotekës është bërë përmbyllja e vitit 2021 te prezentuar nga kryetari,
- Kemi marr pjesë në senacën e kuvendit komunal të thirrur me datë 24.12.2021,
- Është liruar salla “Better Life”, nga qendra e vakcinimit dhe është kthyer orari I rregullt i ushtrimeve të klubeve sportive.

STATISTIKAT

Në vazhdim paraqesim raportin në formën tabelare:

1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1, -- Pasqyra totale e lëndëve të pranuara nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Proces	Të Pazgjidhura
9	5	-	4	-

Tabela- 2, -- Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Në proces	Vërejtje : Te hyrat:
4	5	54	-	27.00€

Tabela- 3, -- Raport për Biblotekën e Qytetit në Lipjan

Vendi	Libra në huazim	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexues në sallën e leximit	Libra të dhuruara
Sektori për fëmijë	59	50	21	-	98	-
Sektori për të rritur	40	23	9		813	-

Tabela- 4, -- Raport për Biblotekën në Gadime

Libra në huazim	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexues në sallën e leximit
35	35	8	-	-

Tabela- 5, -- Raport për Biblotekën në Shalë

Libra në huazim	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexus në sallën e leximit
-	-	-	-	-

Biblioteka ka hapur dyert edhe për lexues nga muaji shtator 2020, me lirimin e masave në luftën kundër pandemisë globale Covid – 19, nga niveli qendror. Gjithashtu orari i punës së bibliotekës është kthyer deri në orën 19:00.

DISKUTIME PUBLIKE

Gjatë muajit dhjetor, janë realizuar diskutime publike me qytetare te komunës së Lipjanit, debat i thirrur nga kryetari i komunës z.Imri Ahmeti.

TAKIME TJERA

Gjatë muajit dhjetor janë realizuar takime fizike me palë, duke respektuar rekomandimet e IKSHPK-së për distancë fizike, duke mos përjashtuar edhe takimet online të cilat i kemi pasur si pjesë e aktiviteteve tona të përditshme.

SFIDAT

Nuk kemi hasur në ndonjë sfidë në këtë periudhë kohore, me përjashtim të përcjelljes së aktiviteteve në përputhje me rregullat e reja Covid – 19.